



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 629 prot. i AK, datë 24.10.2022 “Kërkesë” me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përftrimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë AIR BP ALBANIA SHA nga shoqëritë BP Holdings International B.V. dhe United World Technologies B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshje e shitjes së aksioneve”, palët janë:

**Pala Blerëse: United World Technologies B.V.** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez, e cila vepron në fushën e aviacionit.

United World Technologies B.V. zotërohet nga Stichting Administratiekantoor United World Technologies.

**Pala Shitëse: BP Holdings International B.V.** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: të marrë pjesë, të financojë, të bashkëpunojë, të udhëheqë menaxhimin e kompanive dhe ndërmarrjeve të tjera dhe të ofrojë këshilla dhe shërbime të tjera etj. BP Holdings International B.V. zotërohet nga aksionari i saj i vetëm BP Europe SE.

BP Holdings International B.V. dhe BP Europe SE janë pjesë e Grupit BP.

**Shoqëria Target: AIR BP ALBANIA SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprime biznesi në fushën e tregtimit me shumicë të lëndëve djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive, si dhe karburanteve për avionë dhe mjete motorike etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**